



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 624 Akti

Nr. 466. Vendimi  
Tiranë, më 28.10.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Alma Faskaj</b>	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 28.10.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Qani Hasa**, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017** i Gjykatës Kushtetuese.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe pasi analizoi çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

**V Ë R E N:**

1. Z. Qani Hasa ka qenë subjekt rivlerësimi, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime

në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim ligji nr. 84/2016), i cili i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, me shortin e hedhur, në datën 15.12.2020, në përputhje me "Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit".

3. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin ka filluar menjëherë me caktimin me short të trupit gjykues të përbërë nga komisionerët: Xhensila Pine (relatore), Pamela Qirko dhe Alma Faskaj.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga institucionet ndihmëse. Trupi gjykues ka caktuar me mirëkuptim, kryesuese znj. Pamela Qirko, si dhe ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit nga anëtarët e tij.

5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nga subjekti janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

- a. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. Plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

6. Komisioni, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për subjektin e rivlerësimit Qani Hasa, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

7. KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021, ka dërguar dokumentacion të plotë, ndër të tjera, edhe kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 17.11.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), mbi shkarkimin nga detyra z. Qani Hasa, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë.

8. KLD-ja, bazuar në pikën 2, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës, si dhe në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka vlerësuar se vendimi nr. \*\*\*, datë 13.7.2017, i Gjykatës së Apelit, ka lënë në fuqi vendimin nr.\*\*\*, datë 23.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili e ka konsideruar fajtor dhe ka dënuar gjyqtarin Qani Hasa për kryerjen e veprës penale "refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë", parashikuar nga neni 257/a, paragrafi 2, i Kodit Penal.

9. Ky vendim është i formës së prerë dhe detyrim për t'u zbatuar. KLGJ pasi ka evidentuar se vendimi penal i dënimit ka marrë formë të prerë, ka vendosur të shkarkojë nga detyra gjyqtarin Qani Hasa.

**10.** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pikën 2/b, të nenit 140, përcakton se gjyqtari shkarkohet nga detyra, kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë.

**11.** Nga verifikimi i çështjeve për ankimet, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, rezultoi se nuk është regjistruar ankim nga z. Qani Hasa ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 17.11.2017, të KLD-së.

**12.** Rezulton se ndaj gjyqtarit Qani Hasa është marrë masë disiplinore e shkarkimit nga funksioni nga organi kompetent sipas ligjit të kohës, ish-KLD-ja, vendim kundër të cilit gjyqtari i shkarkuar nuk ka paraqitur ankim brenda afatit të përcaktuar me ligj.

**13.** Për këto arsye, vendimi nr. \*\*\*, datë 17.11.2017, i ish-KLD-së, konsiderohet se ka marrë formë të prerë, duke pasjellë efektet ligjore përkatëse dhe mbarimin e statusit të magjistratit, sipas parashikimit të germës “ç”, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**14.** Z. Qani Hasa, i pyetur nga Komisioni, ka deklaruar se: *“Në kohën që kërkohet plotësimi i dokumentacionit kam plotësuar të gjithë dokumentacionin për t’iu nënshtruar këtij procesi, pasi në atë periudhë isha i pezulluar, jo i shkarkuar nga detyra, pra, gëzoja statusin e gjyqtarit. Aktualisht me shkarkimin tim unë e kam humbur këtë status ...”*.

## **II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**15.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**16.** Trupi gjykues konstaton se z. Qani Hasa ka qenë me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke qenë subjekt që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*.

**17.** Në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: *“Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni”*.

**18.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2017, të KLD-së, z. Qani Hasa është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të një dënimi penal të formës së prerë, vendim ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim.

**19.** Z. Qani Hasa i ka mbaruar statusi i magjistratit, pasi “shkarkimi nga funksioni” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të germës “ç”, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**20.** Nenin 95 i Kodit të Procedurave Administrative, ka parashikuar pamundësinë në objekt apo qëllim, ku sipas kësaj dispozite, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

**21.** Trupi gjykues arrin në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative pa një vendim përfundimtar.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Qani Hasa, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë në datën 28.10.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**

**Xhensila PINE**  
**Relatore**

**Alma FASKAJ**  
**Anëtare**

*Sekretare Gjyqësore*  
*Elda Faruku*